LIGJ
Nr.10 471, datë 20.10.2011

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË PËR EKSPORT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË VEPRON NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, I PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "FURNIZIMI ME UJË I BILISHTIT-KONTRATË ME ÇELËSA NË DORË""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe UniCredit Bank Austria AG për financimin e projektit "Furnizimi me ujë i Bilishtit - kontratë me çelësa në dorë"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7144, datë 31.10.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi